

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE AKSIONERE "SPORT BET 24" SH.A



Sot, me date 17.08.2018 (dymije e tetemdhjete), ne Tirane, aksioneri i vetem:

- Znj. **Albana MASHA**, shtetase shqiptare, atesia Bajram, lindur me dt.27.07.1987 ne Tirane, banuese ne Tirane, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me karte identiteti Nr. 027726329 me nr sigurimi I75727056L;

Ne cilesine e themelueses te Shoqerise "Sport Bet 24" SH.A nënskruan dhe miraton këtë Akt Themelimi te shoqerise anonime me oferte private "Sport Bet 24" SH.A:

NENI 1

Krijohet shoqeria anonime "Sport Bet 24" SH.A duke u bazuar ne Aktin e Themelimit dhe ne Statut sipas legjislacionit shqiptar.

Emri tregëtar i shoqerise do te jete "Sport Bet 24" dhe "Top Sport Bet" te cilet do te perdoren ne te gjitha reklamimet publike.

NENI 2

Selia e "Sport Bet 24" SH.A eshte ne Njesia Administrative Nr 5, Rruga Prokop Mima, Pallati Pajtoni, Kati 2, Tirane, Shqiperi.

Adresa Zyrtare e shoqerise do te jete:

Njesia Administrative Nr 5, Rruga Prokop Mima, Pallati Pajtoni, Kati 2, Tirane, Shqiperi

NENI 3

Aktiviteti i Shoqerise eshte:

Organizimin dhe Zhvillimin i Lojrave te Fatit te Kategorise "Basteve Sportive", te parshikuara ne Ligjin Nr. 155/2015 dt 21.12.2015 "Për Lojërat e Fatit në Republikën e Shqipërisë" si dhe çdo lloj veprimtarie tjeter te lidhur me lojërat e basteve sportive, perfshire por pa u kufizuar ne baste sportive online, krijimin dhe menaxhimin e programeve te lojes se basteve, distribucion dhe marketim ne pale te treta te programeve ndihmese te basteve sportive dhe çdo lloj veprimtarie tjeter tregtare te lidhur apo ne funksion te ushtrimit te veprimtarise se lojrave te fatit ne katorine baste sportive.

Shoqeria mund te kryeje edhe cdo lloj aktiviteti tjeter qe ka lidhje te mjaftueshme me objektin e aktivitetit te saj, qe konsiderohet i dobishem per permbushjen e aktivitetit te saj dhe qe nuk eshte i ndaluar nga ligji shqiptar ne fuqi duke realizuar per qellime te saj edhe import- export te cfaredo lloj produkti qe lidhet me aktivitetin e shoqerise.

NENI 4

Kapitali i Plote Aksioner

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte ne vleren 20.000.000 (njetzet milione) leke, me vlerë nominale të një aksioni 1,000 leke dhe totali i aksioneve 20.000 te cilat perbejne 100% te kapitalit te shoqerise, i nenshkruar rregullisht nga aksioneri i vetem si më poshtë:

- **Albana MASHA**, shtetase shqiptare, atesia Bajram, lindur me dt.27.07.1987 ne Tirane, banuese ne Tirane, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me karte identiteti Nr. 027726329 me nr sigurimi I75727056L.

Kapitali Fillestar I Shlyer

Kapitali fillestar i shlyer (investuar) i shoqërise prej Aksionerit te vetem Themelues ne leke eshte ne masen 5.000.000 (pese milione) leke, dhe perben ¼ (nje te katerten) e vleres se kapitalit themeltar. Pjesa tjeter e nenshkruar e kapitalit themeltar do te shlyhet nga aksioneri i shoqërise ne nje nga format e parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

NENI 5

Kohezgjatja e afatit te Veprimtarise se shoqërise Sport Bet 24 sh.a. eshte e pakufizuar.

NENI 6

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

Administratori i parë i Shoqërisë "**Sport Bet 24**" SH.A. do te jete Znj. **Albana MASHA**, shtetase shqiptare, atesia Bajram, lindur me dt.27.07.1987 ne Tirane, banuese ne Tirane, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me karte identiteti Nr. 027726329 me nr sigurimi I75727056L, e cili zgjidhet per afatin 3 vjecar me te drejte riperteritje.

Aktiviteti I administratorit mbikqyret nga keshilli mbikqyres.

Keshilli I pare Mbikqyres I shoqërise per nje afat tre vjecar, do te perbehet nga keta Anctare :

1. Z. **Andi MËRTIRI**, shtetas shqiptar, atesia Alfred, lindur me dt.29.09.1985 ne Sarande, banues ne Tirane, Njesia Administrative nr 5, Rruga Peti, tek Kopshti Botanik person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me me karte identiteti Nr. 025153445 me nr sigurimi I50929091D;
2. Z. **Dorian KASHURI**, shtetas shqiptar, atesia Novruz, lindur me dt.23.09.1983 ne Tirane, banues ne Tirane, Njesia Administrative nr 7, Rruga Bab Rexha, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me karte identiteti Nr. 027738376 me nr sigurimi I30923018U;
3. Z. **Ervis FUÇIA**, shtetas shqiptar, atesia Enver, lindur me dt.13.04.1983 ne Tirane, banues ne Njesia Administrative nr 2, Rruga Ali Demi, Pall 54/2, Tirane, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me karte identiteti Nr. 027651085 me nr sigurimi I30413058D.

Organi me I larte vendimarrës I shoqërise eshte Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme dhe e Jashtezakonshme e Aksionereve.

Kontrolli Financiar I shoqërise do te realizohet nga nje ose disa Eksperte Kontabel te Autorizuar e te caktuar nga Asambleja e Aksionereve te shoqërise sipas proceduarave te parashikuara ne statutin e shoqërise.

NENI 7

Aksioneret e shoqërise jane nominative dhe perfaqsohen nga nje çertificate ose mund te jene te paçertifikuar . Çertifikatat do te nenshkruhen ne emer te shoqërise, prej administratorit, dhe do te vulosen me vulen e shoqërise.



NENI 8

Viti financiar I shoqerise fillon ne Janar dhe mbyllet ne 31 Dhjetor me perjashtim te vitit te pare I cili nuk fillon ne janar.

NENI 9

Shoqeria do ta ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me dispozitat e parashikuara ne kete akt themelimi, dispozitat e statutit te saj si dhe ne perputhje te plote me gjithe legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

Aksioneri Themelues

Albana Masha

Znj. Albana MASHA

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'Albana Masha', written over a horizontal line. The signature is stylized and cursive.

REPubLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTERE ANILA Q. KAÇUPI
Nr. 3882 REP

VERTETIM

Sot ne daten 20.08.2018 (dymije e tetembdhjete) u paraqit personalisht para meje Notere Anila Kacupi me adrese Rr." Reshit Çollaku",pall.Aurora, Tirane, :

Albana Masha, atesia Bajram, lindur me date 27.07.1989 ne Tirane dhe banuese Tirane, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, i pajisur me dokument identifikimi Leternjoftim ID me Nr.I75727056L

Personi i mesiperm, madhore dhe zotesi te plote per te vepruar per identitetin e te ciles u sigurova nga dokumenti i saj personal, ka nenshkruar rregullisht dokumentin " Akt Themelimi i Shoqerise Aksionare "Sporte Bet 24" sha"dhe une, Noterja, e vertetoj nenshkrimin e saj sipas ligjit.



NOTERE

ANILA KAÇUPI

Anila Kacupi